



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS
01 Nr. 060/01-26245/2022
Datë.24.11.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dhjetë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2022 e mbajtur me dt.24.11.2022, me fillim në orën 10.00, në sallën Solemne të Pallatit të Kulturës rruga UÇK Gjakovë.

Mbledhjen e kryesoi: znj. Arbënesha Kuqi , Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës .

Në mbledhje marrin pjesë **33** anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Agustin Shala, znj. Albina Sadrija, znj. Teuta Pallaska Milla, z. Nik Hiseni, z. Hekuran Hoxha z. Valon Pnishi, z. Him Zeqa, znj. Ermira Mehmeti, znj. Albulena Zuka, z. Besim Kadrija z. Ngadhnjim Dana, znj. Mimoza Shala, z. Mustafa Domi, znj. Diana Qarkaxhija z. Ali Tafarshiku, znj. Shqipe Fejza z. Agon Dobruna, z. Ermal Kusari, z. Bashkim Gashaj, z. Liridon Dula, z. Teki Shala, z. Nexhdet Morina, znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Besim Ndau, z. Ardian Nushi, znj. Leren Kameran, znj. Krenare Bushaj, z. Fazli Hoxha.

Mungon: z. Kreshnik Alijaj, z. Ledian Rexha, , znj. Lirianda Dahsyla, me arsye

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës së Gjakovës, Nënkryetari i Komunës së Gjakovës z. Flamur Fetahaj, Drejtor të Drejtorive Komunale, përfaqësues të Mediave të OJQ-ve, të OSBE, qytetar të Komunës së Gjakovës, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal.

Kryesuesja: I nderuar Nënkryetar i Komunës, z. Flamur Fetahaj, Të nderuar anëtarë të pranishëm të Kuvendit të Komunës, Të nderuar Drejtor të drejtorive Komunale, përfaqësues të Mediave, të OSBE, Zyrtar Komunal të nderuar të pranishëm.

Fillimisht me Lejoni që ti shprehi ngushëllime Kolegut ton z. Ledian Rexha me rastin e vdekjes së Babait, ngushëllime edhe në emër të gjitha anëtarëve të Kuvendit. Sot e kemi mbledhjen e **dhjetë** të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2022, Materialin dhe ftesën për këtë mbledhje ju kemi shpërndarë sipas afateve të parapara ligjore. Të papranishëm në këtë mbledhje janë 32 anëtarë, znj. Lirianda Dahsyla, mungon me arsye, gjithashtu edhe z. Ledian Rexha, andaj meqenëse ekziston Korumimi po fillojmë me mbledhjen. Rëndin e ditës me ftesën dhe materialet e mbledhjes, ju kemi dërguar me kohë, E kemi edhe një kërkesë për pikë shtesë të rendit të ditës: Propozim Vendim i Kryetarit të Komunës për Shfuqizimin e vendimit nr.01-011-14192/2021 për shpalljen e Interesit Publik në pjesën e parcelës në Degëzimin e Rrugës “ Nëna Terezë“ me qëllim të Shpronësimit për Realizimin e Projektit për Ndërtimin e rrugës. Kërkoj që edhe kjo pikë të futet për diskutim në pikën e 3 të rendit të ditës për këtë mbledhje.

A ka dikush ndonjë diskutim sa i përket rendit të ditës.

E Qes në Votim Miratimin e Rendit të Ditës sipas Ftesës që e keni marrë, dhe propozimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të datës 31.05.2021. **Kush Është: Për, Kundër, Abstenim.**

Nga anëtarët e pranishëm unanimisht u votua pro rendit të ditës.

Pas votimit të bërë u miratua ky :

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 28.09.2022 dhe procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 26.10.2022
2. Propozim Vendim i Kryetarit të Komunës për Shfuqizimin e vendimit nr.01-011-14192/2021 për shpalljen e Interesit Publik në pjesën e parcelës në Degëzimin e Rrugës “ Nëna Terezë” me qëllim të Shpronësimit për Realizimin e Projektit për Ndërtimin e rrugës
3. Pyetje për ekzekutivin nga anëtarët e Kuvendit.
4. Shqyrtimi i Draft Rregullores Komunale për Shqyrtimin e Ankesave në Institucionet e Arsimit Para universitare .
5. Themelimi i Komitetit për Kulturë, Rini, Turizëm dhe Trashëgimi Kulturor .
6. Raporti i Komitetit për Komunitete në Komunën e Gjakovës .
7. Të ndryshme.

1. Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 28.09.2022 dhe procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 26.10.2022

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 28.09.2022 dhe procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 26.10.2022 .

E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës nëse ka dikush ndonjë vërejtje për procesverbalet e dy mbledhjeve .

Megenëse nuk ka diskutime e qes në Votim Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt.

28.09.2022 dhe procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 26.10.2022 kush është: **Për , Kundër**

Abstenim .

Nga anëtarët e pranishëm unanimisht u miratuan procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 28.09.2022 dhe procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 26.10.2022.

2. Pika e dytë e rendit të ditës: Pyetje për Ekzekutivin nga anëtarët e Kuvendit .

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Pyetje për ekzekutivin .

E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

z. Teki Shala: Pyetjet e mija kanë të bëjnë lidhur me këtë situatë që është krijuar pas të reshurave që kanë ndodhur, andaj jam i detyruar sepse gjendja është shumë e rëndë , Si rezultat i shirave që kanë rënë në këto ditë, dhe keq menaxhimit të qeverisë komunale, Rugova është në një gjendje shumë të rëndë nga vërshimet që do të ishte evituar shumë lehtë me ndërtimin e kanalit të ujërave atmosferik që ka filluar para 5 viteve dhe ka rinisur në fushatën elektorale të vitit të kaluar, e keni parë që edhe shtëpia e Kulturës ka lundruar në këto ujar për shkak se ende nuk është përfunduar qe sa vite, Andaj pse nuk u realizuar ky projekt ashtu siç jeni zotuar disa herë edhe apra qytetarëve edhe këtu në Kuvend , ju rikujtoj se ky projekt është përgatitur nga kompania e kontraktuar nga komuna dhe ka qen dashur të ishin paraparë të gjitha detajet , Kryetari i këshillit Lokal të Rugovës ka parashtruar disa kërkesa për ndërtimin e përroit të Bellajes por asnjëherë nuk është janë marrë masa, pyetja është se a e keni ndërmend të merri me zgjidhjen e këtyre problemeve të mëdha e jo të kushtueshme, Sot banorët e Rugovës janë para një izolimi total sepse ura është dëmtuar dhe është e pa kalueshme, nga ajo që e kamë vërtetur është se ura është e mbyllur për kalim andaj pyetja ime është se deri kur duhet të presim për këtë urë nuk është arsyetim se po e presim Qeverinë për hartimin e projektit sepse keni pasur mundësi me i ndjek procedurat e përsheptuara dhe me e hartua projektin e kësaj ure dhe me fillua rindërtimin sepse po ju rikujtoj se ura është përgjegjësi e komunës dhe ka qenë dashur deri më tani të filloj rindërtimi , nga të gjitha këto që u thanë nuk na ka mbetur gjë tjetër vetëm të dalim në protesta dh eta bllokojmë rrugën magjistrale për Prizren .

z. Ali Tafarshiku: Fatkeqësisht këto dit jemi përballur me të reshura të shumta dhe për shumë familje kanë qenë ditë të rënda nga përmbytjet edhe pse ende nuk e kemi një raport nga dëmet e reshjeve të kaluara andaj ka qenë mirë të kemi një raport për këtë çështje . Trajtimi i kërkesave dhe zgjidhja e çështjes së banimit për qytetarët që i shfrytëzojnë banesat që ende nuk kanë të drejtë me i shfrytëzua ato banesa dhe nuk kanë asnjë dokument valid për shfrytëzimin e tyre kjo është një çështje që shumë vite dhe kemi marrë edhe nisma dhe iniciative pro Qeverisja komunale nuk ka marrë asnjë hap , Tani është e hapur procedura për aplikimin për blerjen e këtyre banesave është i themeluar edhe komisioni, por ka pasur shfrytëzues që i kanë qe 20 vite dhe ato aplikacione janë refuzuar sepse ju mungon e drejta e shfrytëzimit , dhe po ti shikojmë dokumentet ato ti kanë disa shfrytëzues në serbi dh ene nuk i kemi marr asnjë veprim si komunë për rregullimin e kësaj çështje andaj kërkoj që komuna e Gjakovës përmes një komisioni të del në teren dhe të ju njoh të drejtën e shfrytëzimit këtyre banoreve që e shfrytëzojnë.

Projekti i impiantit të ujerave të zeza është përfunduar por nuk është finalizuar dhe kjo ka mbet si pasoj e mos shlyerjes së obligimeve nga Komuna e Gjakovës , sepse KFW-ja e ka kryer pjesën e vet , pse ka ardhur situata deri këtu, deri ku ka arritur projekti i komunësës re a keni komunikim se deri kur do të përfundon ky projekt, si dhe për ndriçimin publik në fshatin Jahoc rruga e Rrypes si dhe mbeturinat inerte dhe trajtimi i qeneve endacak.

znj. Dianan Qarkagjija: Në rrugën Dëshmorët e Lirisë rruga që shpije për në spital ndërtimet veç sa së po vazhdojnë dhe ndërtesat që janë ndërtuar më herët e kanë vijën e ndërtimit 3 ose 4 metra më largo prej rrugës ndërsa kjo e fundit tani e ka rreth një metër a i kontrollon dikush këto çështje.

znj. Mimoza Shala: Edhe në këtë mbledhje që sa po filloj patëm shqetësime për ndriçimin Publik , në të gjithë mbledhjet qoftë nga ane tretë pozitës apo opozitës ka pasur kërkesa dhe vërejtje për ndriçimin publik dhe çdo herë kemi mare përgjigjeje kontrata e mirëmbajtjes kontrata e zgjerimit e të ngjashme sa që kamë ardhur në përfundim se të pa vërtetave të veta ka fillua me ju besua drejtori i shërbimeve publike sepse qe dy muaj jemi në komisionin e zgjedhjeve të këshillave lokal dhe i kemi pa se në çfarë gjendej është ndriçimi publik në kominën e Gjakovës , andaj unë e kamë një pyetje për drejtorin, a e ke në plan me dal me kerr dhe me i pa gjendjen e ndriçimit publik kjo vlen për krejt komunën e Gjakovës sepse janë krejt në terr.

znj. Krenare Bushaj : Shqetësimi për Ndriçimit Publik i bashkëngjitëm edhe unë si dhe pas reshjeve nuk kanë pasur dëmtime vetëm në urat e mardhaja por dëmtime kanë pasur edhe disa ura të vogla siç janë Ura në Fsh. Trakaniq dhe në Novosellë që po paraqesin rrezik sidomos për nxënësit e këtyre fshatareve .

z. Shkumbim Kastriati: Ndriçimi Publik në Komunën e Gjakovës diku afër 80% është i përfunduar ndërsa sa i përket kanalit të ujërave Atmosferike në Rogovë ende nuk ka përfunduar ai projekt dhe ju e dini se në ditët e fundit ka pasur të reshura dhe menjëherë si të përmirësohet koha do të kryhet ky projekt dhe ju keni qenë prezent për të gjitha to probleme , Për Lumin Bellaja ekipet komunale kanë dalë në teren dhe janë evidentuara pikat e rrezikshme ku ka nevojë me ndërhy . Për Urën e Rogovës fillimisht Komuna ka bërë marrëveshjen me fakultetin e ndërtimtarisë për identifikimin e rrezikut dhe formës që do të ndërhyhet, dhe para dy ditëve e kemi marrë elaboratin se si do të veprohet me urën . Rekomandimi ka qenë se ura paraqet rrezikshmëri të larët dhe vendimi ka enë për mbylljen e urës në këtë fazë dhe dëmtimi ka pasua edhe në ujz dhe për dy ditë kanë punuar ditën e natën për me e rehabilitua urën në Ujë dhe pasi që është aktivizua ajo rrugë e kemi mbyll urën e Rogëvës . Qytetarët e zonës së Rogëvës dhe fshatrave tjera është alternativa për Ujëz dhe për Lubizhdë me dal në magjistrale , kjo është gjendja për momentin, Komuna e Gjakovës 3 vite rresht ka ndarë mjete për ndërtimin e kësaj Ure por pengesa ka qene në Ministri sepse tri herë janë hekë mjetet nga Qeveria. Për financimin e impiantit, me 29 të këtij muaj e kemi takimin e grupit punues dhe projekti është duke vazhduar dhe procesi është ë vazhdim , për Ndriçimin publik javën e kaluar është nënshkrua kontrata e mirëmbajtjes së ndriçimit publik dhe tani për zgjerim të rrjetit jemi duke punuar në fshatra me dy ekipe dhe një ekip në Qytet, gjendja ka qen e keqe por tani është përmirësuar dukshëm dhe do të rregullohet në të gjitha fshatrat dhe në qytet .

z. Durim Halilaj: Për Impiantin jemi takuar edhe me KRU Gjakova ky projekt është në vazhdimësi dhe ne si komunë kemi hy në obligime në vlerë prej 3.2 milion euro dhe tani kemi filluar me pagua për çdo muaj nuk është faj i komunës së është ngadalësuar projekti dhe Komuna e Gjakovës në vitin 2022 i ka paguar për këtë projekt afër 1 milion euro, për Urën e Rugovës ne jemi takuar me zv. Ministrin e infrastrukturës dhe janë ndarë nga 500,000€ për tri vite dhe ne kemi kërkuar që mos të kryhet ky projekt për 3 vite por të kryhet për një vit , dhe sa i përket mjeteve të ndara dhe largimin e këtij projekti prej Buxhetit të Republikës së Kosovës kërkon se kush ka qanë ministër i infrastrukturës dhe kush e ka hek nga buxheti këtë projekt .

z. Flamur Fetahaj: Çështje e banesave Komisioni është duke punuar dhe duke i shqyrtuar dokumentacionet por ende nuk kemi marrë asnjë vendim lidhur me ato banesa dhe do të veprojmë në harmoni të plot me ligjin, për ndërtesën e Komunës projektin e ka kryer BE-ja dhe menaxhimin në tërësi e ka BE-ja dhe ne si komunë jemi bashkë financues dhe nuk e kemi në dorë vonesën që ka ndodhur , por jeni të informuar sepse projekti i parë ka qenë me mbet objekti i vjetër por pastaj pas analizave të ekspertëve ai objekt është rrënuar dhe ka fillua nga fillimi , sipas përfaqësuesve të BE-së ky objekt do të përfundoj në Muajin Shkurt .

z. Haxhi Sejdiu: Komisioni në muajin Shtator e ka bërë vlerësimin e dëmeve në ekonominë familjare dhe në Biznese, dhe pas hartimit të raportit përmes Kryetarit të Komunës ja kemi përcjellë në Ministrinë dhe përmes agjencionit për emergjencë e kanë kërkuar një ndryshim të formës së aplikimit dhe jemi në procedura për hartimin e atyre dokumenteve që po kërkojnë . Këto reshej ka pasur disa përmbytje por kanë qenë më të izoluara sidomos në ekonominë familjare ekipet tona kanë qenë në gatishmëri dhe kanë qenë në teren ka pasur intervenime gjithkund k është kërkuar, kemi pasur disa rrëshqitje të dheut në disa vende

z. Ali Tafarshiku: Unë kërkoja pyetje shtesë sepse asnjëherë nuk po marrim përgjigjeje konkrete , sepse ne flasim për urën e Rugovës ju tregoni kush ka qenë Ministër në vitin 2019, për impiantin e ujerave të zeza nuk tha që është përmbyll projekti por për borxhin 970,000€ janë borxh .

znj. Mimoza Shala: Drejtori i Shërbimeve Publike tani shkoj por nuk mora përgjigjeje sepse unë nuk i bëra pyetje se çka doni me bë por e pyeta se a donë me dal vet me i pa rrugët e Gjakovës se në çfarë gjendje janë krejt në terr .

z. Teki Shala: Deri kur duhet të hartohet aj projekt sepse këtu thirren në Qeveri e deri më tani nuk është marrë me këtë projekt as Qeveria Qendrore e as nga ajo Komunale.

z. Flamur Fetahaj: Përgjigjeje në pyetjet e juaja ne po i japim ashtu siç janë për dikën nuk janë të duhura por për shumicën janë të cakta . Sa i përket komisioni për shitjen e Banësve Komisioni është aktiv dhe është duke punuar kështu që ata janë kompetent dhe do të vendasin .

Kryesuesja: Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

3. Pika e tretë e rendit të ditës: Propozim Vendim nga Kryetari të Komunës për Shfuqizimin e vendimit nr.01-011-14192/2021 për shpalljen e Interesit Publik në Pjesën e Parcelës në Degëzimin e Rrugës “ Nëna Terezë “ me qëllim të Shpronësimit për Realizimin e Projektit për Ndërtimin e rrugës .

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Propozim Vendimin e Kryetarit për shfuqizimin e vendimit nr.01-011-14192/2021 për shpalljen e Interesit Publik në Pjesën e Parcelës në Degëzimin e Rrugës “ Nëna Terezë “ me qëllim të Shpronësimit për Realizimin e Projektit për Ndërtimin e rrugës, ky propozim vendim ka ardhur me qëllim që mos të realizohen procedurat tjera për shpronësimin e parcelave që janë të përfshira në atë vendim por të realizohet e drejta që sipas drejtorisë për Kadastër është ekzistuese SERVITUTI, për sqarime më të hollësishme e ftoj drejtorin z. Gjevalin NikollBibaj, që ta merr fjalën .

z. Gjevalin Nikollbibaj : në Vitin e kalaur kuvendi ka marrë vendim për shpalljen e Interesit Publik në Pjesën e Parcelës në Degëzimin e Rrugës “ Nëna Terezë “ me qëllim të Shpronësimit për Realizimin e Projektit për Ndërtimin e rrugës, ku realisht ka rrjedh një gabim teknik pasi që në këtë parcelë është e drejta e Servitutit dhe nuk kemi nevojë të krijojmë shpenzime të pa nevojshme sepse ka të drejtë kalimi andaj kërkoj që ta mbështesni këtë propozim vendim për shfuqizimin e këtij vendimi .

Kryesuesja : E Hapi Diskutimin për këtë pikë .

Meqenëse nuk ka diskutime e Qes në votim Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 28.09.2022 dhe procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 26.10.2022 . **Kush Është Për , Kundër, Abstenim**

Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit unanimitisht u votua pro: Pas votimit të bërë u miratua Ky :

V E N D I M

Për

Shfuqizimin

e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.01-011-14192/2021 i datës 31.05.2021 .

1. Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës nr.01-011-14192/2021 i datës 31.05.2021 për Shpalljen e Interesit Publik në pjesët e Parcelave : 5797-0, 1032-1, 1032-3, 1032-4, dhe 1032-5, në Degëzimin e Rrugës “ Nëna Terezë “ me qëllim të Shpronësimit për Realizimin e Projektit për ndërtimin e rrugës .
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

4.Pika e katërt e rendit të ditës: Shqyrtimi i Draft Rregullores Komunale për Shqyrtimin e Ankesave në Institucionet e Arsimit Para universitare

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Draft Rregullores Komunale për Kutitë e Ankesave në Institucionet e Arsimit Para universitare , ky dokument është hartuar nga një grup punues i cili është ndihmuar dhe përkrahur nga Organizata Syri Vision , Rregullorja është unike në të gjitha komunat e Kosovës dhe është diskutuar nga palët e interesuara dhe shkollat e Komunës së Gjakovës .

Ky dokument është hartuar duke u bazuar në Obligimet ligjore që i kanë Drejtorit Komunale të Arsimit për Kutitë e Ankesave dhe është diskutuar edhe në mbledhjen e fundit të KPF-së, ndërsa për sqarime më të hollësishme prezent e kemi Drejtoreshën znj. Eranda Baçi të cilën e ftojme që ta merr fjalën .

znj. Eranda Baçi: Ky dokument është një draft rregullore që është iniciuar nga organizata Syri Vizion dhe është unike për të gjitha komunat , ky dokument ka kaluar në procedurat e kërkuara dhe ne komunën tonë nuk është miratuar ende dhe sot ju kamë prezantuar para jush që të miratohet dhe do të rregullohet mënyra e funksionimit të vendosjes dhe të hapjes së ankesave në institucionet para universitare andaj kërkoj nga ju që ta miratoni sepse është e nevojshme e dobishme për Institucionet tona para universitare .

Kryesuesja : E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës E qes në Votim miratimin e Rregullores Komunale për Shqyrtimin e Ankesave në Institucionet e Arsimit Para universitare. **Kush Është Për , Kundër, Abstenim. Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit unanimitisht u votua pro: Pas votimit të bërë u miratua Kjo :**

RREGULLORE

KOMUNALE

**PËR HAPJEN E KUTIVE TË ANKESAVE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

5. Pika e pestë e rendit të ditës: Themelimi i Komitetit për Kulturë, Rini, Turizëm dhe Trashëgimi Kulturor .

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Themelimi i Komitetit për Kulturë, Rini, Turizëm dhe Trashëgimi Kulturor , themelimi i këtij komiteti është shumë i nevojshëm dhe për këtë arsye e kemi marrë iniciativë që Komuna e Gjakovës tani e tutje të ketë një komitet për Kulturë, Rini, Turizëm dhe Trashëgimi Kulturor, i cili do të na ndihmoj në zhvillimin e këtyre fushave .

Në takimin me shefat e grupeve jemi dakorduar që ky komitet të ketë 7 anëtar, 2 nga ekzekutivi nga fushat përkatëse , 4 nga Kuvendi përfshirë edhe kryesuesen e Kuvendit dhe një nga shoqëria Civile nga organizatat rinore, andaj nga ekzekutivi i kemi marrë propozimet që janë: 1. znj. Adea Roka , Ferdinand Kola, ndërsa nga shoqëria Civile propozime nga Kuvendi do të jemi unë si kryesuese e Kuvendit dhe tani i ftoj që të bëjnë propozimin nga Kuvendi .

z. Nik Hiseni : Në emër të Grupit të AAK-së e propozojmë z. Valon Pnishi .

znj. Mimoza Shala: Nga Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje propozojmë znj. Shqipe Fejza.

z. Teki Shala : Në emër të grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës propozojmë znj. Saranda Hoda

Kryesuesja: Ndërsa nga shoqëria Civile propozime kanë propozuar Altin Hafizjaga
E qes në Votim formimin e komitetit sipas propozimeve të bëra . **Kush Është Për , Kundër, Abstenim .**
Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit u votua kështu: 27 pro , 1 kundër, dhe 0 abstenim : Pas votimit të bërë u miratua Ky :

V E N D I M

1. Themelohet Komitetit për Kulturë, Rini, Turizëm dhe Trashëgimi Kulturor, me këtë përbërje :

1. znj. Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit .
2. znj. Adea Roka, përfaqësuese e ekzekutivit .
3. z. Ferdinand Kola, anëtar i ekzekutivit .
4. znj. Shqipe Fejza, anëtare e Kuvendit .
5. z. Valon Pnishi, anëtar i Kuvendit .
6. znj. Saranda Hoda, anëtare, e Kuvendit .
7. z. Altin Hafizjaga, përfaqësues i Shoqërisë Civile .

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës: Raporti i Komitetit për Komunitete në Komunën e Gjakovës.

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Raporti i Komitetit për Komunitete në Komunën e Gjakovës e ftojmë që ta merr fjalën Kryesuesin e Komitetit për Komunitete z. Ergit Qeli .

z. Ergit Qeli : Sot para jush do ta prezantojmë një raport të Komitetit për Komunitete që ka të bëjë me punën e Komitetit për Komunitete në fillim të këtij mandati ne si komitete jemi dalë në teren dhe kemi zhvilluar vizita nëpër përfaqësuesit e lagjeve që jetojnë komunitete jo shumicë dhe në kudër të kësaj e kemi hartuar një plan të punës që e kemi planifikuar që ti ftojmë edhe drejtorët që kanë të bëjnë me pikat e këtij plani , ku edhe i kemi nxjerr edhe rekomandime e konkluzione për zgjidhjen e problemeve të komuniteteve. Ne kemi një bashkëpunim të mirë me akteretë relevantë për përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet dhe kemi hap një kanal komunikues në rrjetet sociale me komunitetet jo shumicë. Deri në fund të Tetorit i kemi mbajtur gjithsejtë 7 mbledhje ku i kemi diskutuara sfidat që përballen komunitetet dhe kemi nxjerr rekomandime dhe ju kemi drejtuar organeve kompetente. Gjatë kësaj periudhe kemi krijuar një bashkëpunim shumë të mirë me komunitetet dhe kemi bashkëpunuar ngushtë me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim , sikurse në

rastin e përmbytyjeve të fundit që ne e kemi mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme për gjetjen e një zgjidhje, përmirësime kemi tek lagjia Ali Ibra që tani është duke u punua në largimin e mbeturinave dhe asfaltimi i rrugës, kemi probleme në rrugën Shote Galica problemi me kanalizim edhe në lagjen Dardani, për të gjitha a këto problem ju kemi drejtuar organeve përgjegjëse, sfidë është edhe mos punësimi i komuniteteve sidomos i atyre që janë të diplomuar .

znj. Mimoza Shala: Unë ju përgëzoj për punën e juaj si komitet në mandatin e kaluar kemi pasur pakënaqësi me punën e këtij komiteti sidomos me mos angazhimin e Kryesueses se këtij komiteti, ndërsa tani jeni duke punuar shumë më mirë andaj ju falënderoj dhe ju inkurajoj që të angazhoheni edhe më shumë .

z. Ali Tafarshiku: Rrallëherë shohim raporte më përmbajtjesorë andaj ju dorëzoj për këtë punën të bërë , sfidë që komunën e Gjakovës e ka përcjellë është se nuk kemi përfaqësues në kuvend nga Komunitetet në Komunën e Gjakovës andaj komiteti i juaj mbetet mekanizmi i vetëm që mundet me ndikua për komunitete . Ju duheni me qenë më të zëshëm dhe më kërkues qoftë nga drejtorët , nga kryetari apo edhe këtu në Kuvend që të ndikojnë në përmirësimin e jetës së komuniteteve. Sfidë për këtë kohë është caktimi i vendit për grumbullimin e mbeturinave që të pastrohet deponia aktuale dhe mos të ketë më deponi në afërsi të lagjes së komuniteteve sepse aty nuk ka kushte elementare të jetës nuk i plotëson as kushtet as distancën prej vendbanimeve andaj ju duhet të kërkoni me këmbëngulje që të largohet ajo deponi. Të kërkoni zyrtarisht që të bëheni pjesë e grupit punues për hartimin e planit tre vjeçar të banimit .

Kryesuesja: Meqenëse se nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë .

6. Pikë e gjashtë e rendit të ditës : Të Ndryshme

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Të ndryshme , fillimisht dua të ju uroj të gjithë Shqiptarëve kudo që janë festën e Flamurit tonë Kombëtarë Urime të gjithëve .E hapi diskutimin për këtë pikë .

z. Ali Tafarshiku: Nuk është e vërtetë që unë kërkoja përgjegjësi të Komisionit apo përsheptim të afatit apo ngadalësim të procesit , sot i ke qytetarët e komunës së Gjakovës që janë të vendosur menjëherë pas përfundimit të luftës dhe qe 20 vite jetojnë aty dhe nuk kanë asnjë dokument valid që e dëshmojnë se shfrytëzimi i atyre banesave ka qenë i ligjshëm , të drejtat e atyre banesave janë dhënë në kohen e masave të dhunshëm dhe tani meqë ligji është për drejtën e blerjes qytetarët që jetojnë aty nuk mundën me aplikua sepse nuk e kanë të drejtën e shfrytëzimit e tani për me ju mundësua ne si komunë e Gjakovës e mendoni me ndërmarr diçka konkrete që e legjitimon qëndrimin e tyre në banesa të paktën ta kenë një dokument valid që këta banor ka të drejtë me banua në këto banesa pre një vendim të asamblesë që e njohin shfrytëzimin e këtyre banorëve , andaj ju kisha kërkua që mos të krijoni situatën që këta qytetar të dëbohen nga këto banesa

z. Him Zeqa: Unë kamë një kërkesë lidhur me rrugën Shotë Galica në Brekoc aty ka shumë probleme, nuk ka ndriçim dhe është shumë e ngushtë andaj është mirë që komuna të intervenoj aty dhe të rregullohet ajo rrugë , si dhe ndriçimi në rajonin e Lugut të Caragojës nuk është në funksion .

znj. Mimoza Shala: Në buxhet janë ndarë 150,000€ për rrugën Shën Nikolla e që është në gjendje të mjerueshme andaj kërkoj që të punoni në këtë rrugë sepse ka nevojë urgjente. Për fund me lejoni që të uroj të gjithë bashkë kombasëve tonë festa e 28 Nëntorit .

Kryesuesja : Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e Shpalli të mbyllur këtë mbledhje dhe mirë u takofshim në mbledhjet e radhës .**Mbledhja përfundoj në ora 12:20 .**

Procesmbajtës

Burim Bajrami

Arbënesha Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit